

MBI PROBLEMATIKAT E KONSTATUARA NGA AUDITIMET E KLSH-SË NË ENTET MJEDISORE

*nga Mimoza LLOJI¹ – Audituese e Lartë,
botuar në gazetën “55”, më 22 maj 2015.*



KLSH gjatë ushtrimit të veprimtarisë audituese, ka kryer një numër të konsiderueshëm auditimesh në fushën mjedisore, auditime të cilat janë ushtruar në institucionet shtetërore dhe agjencitë zbatuese të legjislacionit për këtë fushë, objekti i të cilave ka qenë auditimi i përputhshmërisë së veprimtarisë së këtyre organeve me legjislacionin e mjedisit, për të

bërë të mundur që këto subjekte të ushtrojnë kompetencat dhe detyrimet, të cilat ligji përcakton në drejtim të mbrojtjes së mjedisit nga ndotjet dhe dëmtimet.

Auditimet janë ushtruar në Ministrinë e Mjedisit, si institucioni kryesor përgjegjës në mbrojtje të mjedisit, në agjencitë nën vartësi si Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Inspektorati Kombëtar i Mjedisit, Agjencitë Rajonale të Mjedisit dhe Drejtoritë e Shërbimit Pyjor, si dhe auditime të performancës

mjedisore në disa bashki, auditime të cilat janë kryer në lidhje me zbatimin e paketës ligjore për këtë fushë ku është konstatuar se paketa ligjore për mjedisin ka qenë jo e plotë, me ekuivoke dhe për pasojë dhe zbatimi i saj në praktikë, ka qenë në shkallë jo të pëlqyeshme.

Nga auditimet është konstatuar se problemet e mbrojtjes së mjedisit kanë filluar të bëhen shqetësim për qytetarët si dhe organizmat e ngarkuar me ligj, etj. Nga subjektet zbatuese në veçanti, nga ato të pushtetit vendor, konstatohet se tendenca për kujdesin dhe përmirësimin e mjedisit urban për arritjen e parametrave që ligji përcakton është me trend pozitiv, si në trajtimin mjedisor të mbetjeve urbane, shtimin e sipërfaqeve të gjelbëtra, përmirësimin e treguesve të ajrit urban dhe të tjerë tregues.

Në vazhdimësi në vite Ministria e Mjedisit ka punuar për ta kompletuar paketën ligjore për mbrojtjen e mjedisit me qëllim për t'a përshtatur dhe për të realizuar përputhshmërinë e saj me standardet e legjislacionit të Bashkimit Europian.

Në këtë kuadër mund të përmendim ndryshimin apo përmirësimin e kuadrit ligjor: si ligji “Për mbrojtjen e mjedisit”, ligji “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis, ligji “Për lejet mjedisore”, ligji “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, përmirësime ligjore në të cilat janë pasqyruar dhe rekomandimet e dhëna nga KLSH.

Por krahas punës së bërë për përmirësimin dhe përshtatjen e paketës ligjore mbi mjedisin në auditime konstatohen se këto organizma nuk kanë vepruar gjithmonë në përputhje me legjislacionin, kanë treguar inkompetencë në

drejtim të politikbërjes për mbrojtjen e mjedisit për rrjedhoje dhe dëmtimi i mjedisit edhe pse është i pamatshëm është evident.

Por, pavarësisht kësaj në këto auditime kanë rezultuar mangësi dhe probleme, të cilat janë shoqëruar me **dëm ekonomik** kryesisht në paga e shpërblime, shpenzime operative si dhe në fushën e prokurimeve publike.

Në mënyrë të përmbledhur, problematikat e evidentuara paraqiten si më poshtë:

Në Entet Mjedisore vërehen mangësi në drejtim të hartimit dhe zbatimit të Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit. Ministritë përkatëse dhe organet e qeverisjes vendore, nuk kanë arritur të bashkëpunojnë dhe koordinojnë veprimet për të përcaktuar të dhënat dhe treguesit që ato do të grumbullojnë mbi gjendjen e mjedisit si dhe për të siguruar të dhëna gjithëvjetoare të pjesëve përbërëse të mjedisit, publikimin e tyre në vazhdimësi, në forma të ndryshme në mënyrë që të realizohet e drejta e publikut për informim mjedisor.

Në lidhje me zbatimin e strategjisë ndërsektoriale për mbrojtjen e mjedisit është konstatuar mungesë koordinimi midis Ministrisë së Mjedisit me institucionet e tjera shtetërore që ligji i ngarkon për mbrojtjen e mjedisit në fushat përkatëse.

Mungesa e një sistemi evidencash ka bërë që të mos pasqyrohen në vazhdimësi arritjet dhe mangësitë në zbatimin e strategjisë mjedisore, të miratuar nga Këshilli i Ministrave, si dokumenti bazë që parashtron politikat shtetërore në këtë fushë.

Për sa më lart pasqyruam, një faktor i rëndësishëm është mungesa e standardeve në rekrutimin e personelit në entet mjedisore, mungesa e trajnimit të specialistëve të fushës, që ka çuar në evidentimin e rasteve të inkompetencës profesionale e pasqyruar në procesin e dhënies së lejeve mjedisore, në kontrollin dhe monitorimin e subjekteve që gjenerojnë mbetje të ngurta, të lëngëta e të gazta etj. apo në dëmtimin e mjedisit gjatë përdorimit të tij.

Njëkohësisht vërehet koordinim jo i plotë midis inspektoratit dhe organeve të pushtetit vendor si dhe organeve të tjera që legjislacioni specifik i ngarkon për mbrojtjen e mjedisit në drejtim të inspektimit dhe kontrollit të përbashkët në subjektet që kanë ndikim të lartë dhe të mesëm në mjedis.

Transferimi i pyjeve dhe kullotave nga pronësia e shtetit në drejtim të Njësive të Qeverisjes Vendore nuk është shoqëruar me kuadrin e plotë ligjor, gjë që ka bërë që situata mjedisore në pyje dhe kullotat komunale të mos njihet nga organet kompetente.

Në kundërshtim me ligjin nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor” i ndryshuar, Drejtoritë e Shërbimit Pyjor, nuk kanë funksionuar në bazë Qarku deri në shkurt 2014, nuk kanë hartuar planet e mbarështimit trajtimit dhe shfrytëzimit të fondit pyjor dhe kullotave, planet e mbarështimit të zonave të mbrojtura, nuk kanë realizuar të ardhurat e programuara, mungon dokumentacioni në kontrata për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kollosor si dhe nuk ndiqet sa e si duhet vjelja e qirave dhe gjobave të vendosura, etj.

Duke konstatuar dëmet e shkaktuara në mjedis kemi rekomanduar *Propozime për ndryshime apo përmirësime në leqjislacionin në fuqi.*

Duke referuar në Direktivën 2008/99/EC të Parlamentit dhe Këshillit Europian të datës 19.11.2008, i kemi rekomanduar Ministrisë së Mjedisit të marrë iniciativën për hartim të ndryshimit të Kodit Penal, kreu IV "Për mbrojtjen e mjedisit nëpërmjet ligjit penal", neni 204, 205.

Për përmirësimin e gjendjes, kemi rekomanduar një numër të konsiderueshëm masa organizative në varësi të problematikës së konstatuar, është kërkuar marrja e masave për shpërblimin e dëmit të shkaktuar dhe njëkohësisht është kërkuar ndëshkimin i personave për mangësitë dhe problematikën e evidentuar gjatë auditimit të enteve mjedisore me masa disiplinore që nga largim nga puna deri në vërejtje me shkrim.

Për këto arsye nga ana e KLSH i është rekomanduar MM që të bëjë një analizë të thelluar të situatës në pyje, kullota dhe zona të mbrojtura dhe mbi bazën e përfundimeve, të hartohen planet e veprimit si dhe rishikimi i paketës ligjore, pasi kanë ndodhur ndryshime të mëdha në drejtim të pronësisë së fondit pyjor, kullotave dhe zonave të mbrojtura si dhe mbi këtë bazë të përcaktohen masat për përmirësimin e gjendjes së tyre.

¹ Shkrime të tjera të botuara nga Mimoza LLOJI dhe Shefki JAUPI për periudhën janar-qershor 2015:

- Ligji i prokurimit publik në Njësitë e Qeverisjes Vendore.
(Botuar në gazetën "55" dhe "Mapo", më 08 maj 2015.)